



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.174/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Rustem Thaqi dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 04.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, me numër Anr.174/2019, e datës 01.10.2019, me të cilën ka kërkuar që të ndërmerren veprimet ligjore kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike.

A r s y e t i m

Organizatës Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, ka paraqitur ankesë në PZAP, me datë 01.10.2019, me të cilën pretendon se me datë 30.09.2019, kandidati për deputet nga radhët e subjektit politik PDK, Gazmend Bytyqi përmes llogarisë së tij në facebook, me disa infermiere, duke bërë fushatë me kategori të personave të ndaluar me Rregullën 13/2013 e Plotësuar me Rregulloren 20/2019 neni 5.2 pika a) dhe një tekst i cili ka shkruar se nëse zgjedhet deputet ka një arsye më shumë që të angazhohet në zhvillimin e shëndetësisë.

Subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), në përgjigje në ankesë të datës 02.10.2019, theksojnë se pretendimet ankimore të Organizatës Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova nuk i konsiderojnë shkelje, sepse secili kandidat ka të drejtë të paraqesë programin me grupet e interesit.

Kandidatët për deputet nga radhët e subjektit politik PDK, kanë nënshkruar një deklaratë noteriale lidhur me respektimin e Kodit Zgjedhor, duke i marr për sipër përgjegjësit eventuale.

Si provë ka bashkangjitur Deklaratën e nënshkruar më LRPNr.06410/2019 e dt. 16.09.2019.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar nga ana e subjektit politik PDK, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin nga fotografit e ofruara si dëshmi për asnjë asnjë moment nuk është arritur që të vërtetohen pretendimet se kemi të bëjmë me ndonjë institucion publik, pra veprimet e përshkuara në ankesë nuk janë në kundërshtim me nenin 35.2 të Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme LZP-së, i cili përcakton se: “ Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore asnjë subjekt nuk inkurajon ose përfiton nga shërbyesi publik duke përdorur pozitën publike të tij ose saj për të zhvilluar fushatë për subjektin politik”, dhe Rregullën 13/2013 e Plotësuar me Rregulloren 20/2019 neni 5.2 pika a).

Paneli për shkeljet e pretenduara në ankesë vlerëson se në rastin konkret nuk ka të bëjë me bërje fushatë duke shfrytëzuar të punësuarit në institucionet shtetërore dhe publike gjatë orarit të rregullt të punës.

Nga arsyet e theksuar më e duke bazuar nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.174/2019 më datën 04.10.2019



Këshillë Juridik: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa në kuptim të nenit 118 par.4 të LZP-së.